

SPRACHBUND -I BALLKANIK DHE TURQISHTJA

Prof. asoc. Dr. ADRIATIK DERJAJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
adriatikderjaj@yahoo.com

ABSTRACT

The kinds of the contacts and relationships between people (and their languages) can vary in many aspects. Some are hostile, some are friendly. Their relationship can be economic, political, anthropological or cultural, religious, etc. They can share similar or different worldviews. Quite similarly, contacts can be polymorphous: direct or indirect, physical or non-physical, geographical or non-geographical. Despite the complexity or intricacy of the nature of the relationship, these contacts somehow have continuously proven to be a great resource of influence and exchange of cultures, worldviews and religions among people and nations whether implicitly or explicitly expressed in one way or another. This linguistic phenomenon resulting from centuries of contact between different languages in the Balkan region and Turkish language evidences the very nature of the relation of the contact languages which somehow determines their positioning towards each other as a “loaning” or “borrowing” language or both, whether one language constitutes “substratum” or “superstratum”, or even “ad stratum”. This paper dwell on the inter-Balkan contacts and contact languages as regards their relationship with the Turkish language viewed from a diachronic aspect.

Keywords: the Balkan sprachbund, Balkanisms, contact languages, Medieval literature.

Cdo gjuhë shfaqet e vetëmjaftueshme në format e saj shprehëse; çdo gjuhë, në një formë apo në tjetrën, arrin që të gjejë rrugët dhe potencialet e veta shprehëse, në varësi të nevojave me të cilat përballen vetë folësit e saj, të cilët shfaqen në të njëjtën kohë edhe lëvruesit dhe mbartësit e dialektikës së saj¹. Vështruar në vetvete, një pozicionim i këtillë është fryt i një gjerdani faktorësh historikë, gjeografikë, politikë, socialë, kulturorë dhe, në mënyrë shumë herë më të theksuar, antropologjikë; shkurt, është fryt i një shkakësie *jashtëgjuhësore*, për të sjellë në kujtesë terminologjinë dhe konceptet e lëvruara nga Bloomfield-i².

Një shembull domethënës në këtë drejtim e hasim në formën më të qashtërt tek të ashtuquajturat “vatrat gjuhësore”, apo *Sprachbunden*, që konceptualisht shënjon një rajon multigjuhësor i përbërë nga gjuhë që i përkasin familjeve të ndryshme gjuhësore, por që, pavarësisht kësaj, shfaqin një varg përafrish strukturore, të cilat, në pjesën dërrmuese, janë fryt i kontakteve që gjuhët kanë patur me njëra-tjetrën.

Ndryshe nga sa ndodh në rastin e “çifteve” gjuhësore, në rastin e një *Sprachbund-i*, një nga tiparet që bie më në sy është mosekzistenca e marrëdhënieve dhe e pozicionimeve *stratike*; shprehimisht këtu, e gjuhëve që shfaqen në pozicionin e një “*substratum*”-i, “*superstratum*”-i dhe “*adstratum*”-i, ku “vatra gjuhësore” ballkanike na paraqet një nga shembujt më të spikatur.

Sprachbund-i Ballkanik shfaq dy tipare vërtet të spikatura; nga njëra anë shfaqet si trevë e “konvergimit gjuhësor”³, ku gjuhët gëzojnë deri diku statusin e të qenit “*adstratum*”, ndërkohë që, nga ana tjetër, në raport me osmanishten dhe dialektet e saj, shfaqin statusin e “*substratum*”-it. Ndërkaq, ndërsa në drejtim të pozicionit “*adstratal*” ndaj njëra-tjetrës, ekzistojnë jo pak mungesa dhe boshllëqe rreth kushteve dhe gjendjeve sociale që shtynë në formësimin e këtij *Sprachbund-i*, në drejtim të pozicionit të tyre “*substratal*” ndaj osmanishtes dhe dialekteve të saj, një pjesë e mirë e rrethanave dhe faktorëve historikë dhe shoqërorë janë të njohura, çka nga njëra anë e lehtëson mjaft ndjeshëm sipërmanjen tonë, ndërkohë që, nga ana tjetër, dhe përkundër çdo ideologjie apo

¹ Fillimisht, një pamësi të tillë e gjejmë të trajtuar gjerësisht nga Platoni, tek Fedhro, 264a etpassim, ndërsa në kohët tona, e gjejmë të

² *Writings on The Language*, Longman, London 1985⁹, f. 276.

³ Lars Johanson, *The Turkic Languages*, Routledge, London 1998, 192 et passim

politike *ultrapuriste*, ndihmon jo pak në ndriçimin dhe vënien në pah jo vetëm të zhvillimeve historike nëpër të cilat ka kaluar një gjuhë e caktuar, në rastin tonë, gjuha shqipe, por edhe format dhe mënyrat se si njerëzit e kanë përdorur gjuhën në një segment të caktuar historik, arsyet që i kanë shtyrë ta përdorin kështu, si dhe gjurmët që kjo formë dhe mënyrë e të përdoruritë gjuhës ka lënë në të folmen e kohëve tona.

Kjo pamje e fundit besojmë se e përligj më së miri këtë sipërmarije; shprehimisht, qëmtimin e pranisë së elementëve orientale në gjuhën shqipe si njëdhjetë e kontaktit gjuhësor mes bashkësisë homogjene të shqipfolësve, dhe asaj heterogjene të osmanishtfolësve.

Personalisht priremi që ta vështrojmë turqishten në pozicionin e “*adstratum*”-it, që shprehimisht do të thotë se nuk është assesi pjesë përbërëse e *Sprachbund*-it ballkanik, por vetëm një nga shumë elementë, ndonëse nga më kryesorët, që kontribuuan në krijimin *Sprachbund*-it në fjalë⁴.

Ndërkaq, nga ana tjetër, pamësinë në fjalë e mbështesim tek turqishtja e periudhës së kontaktit gjuhësor, dhe jo tek dialektet e saj që hasim ndër trevat e ndryshme të Gadishullit Ballkanik⁵, apo në turqishten e periudhës së pas reformave, e cila u përvijua përgjatë kohës kur ky kontakt ishte ndërprerë, madje, interesi dhe priia për t’u përditësuar në drejtim të zhvillimeve gjuhësore të turqishtes ishte zbehur, në mos ishte shuar plotësisht, falë punës jo të pakët që kishin kryer rilindasit, nga njëra anë, si dhe e trysnisë psikologjike që shkaktonte vetvetiu gjuha e një bashkësie tjetër.

Morfofonologjia

Qëmtimi i dukurive në rrafshin *morfofonologjik* shfaq një rëndësi të veçantë në rrafshin e *gjuhësisë historike*, për aq sa ndihmon jo pak në ndriçimin e *kohës së kontaktit gjuhësor* ndërmjet shqipes dhe turqishtes së periudhës së perandorisë osmane, sikundërse edhe në ndriçimin e

⁴ Berstejn 1968, 77-79; Schaller 1975, f. 91-95..

⁵ Në të vërtetë, një drejtim të këtillë rrahu në hulumtimet e tij Victor A. Friedman. Krh., për shembull, *Balkanology and Turcology: West Rumelian Turkish in Yugoslavia as Reflected in Prescriptive Grammar*, në: *Studies in Slavic and General Linguistics*, Radopi, Amsterdam 1982, vëll. II, f. 1-77

gjendjes së kontaktit në fjalë në këtë apo atë fazë të zhvillimeve dhe ndryshimeve që njohu turqishtja e periudhës në fjalë.

Turqizmat e shprehurit ballkanik mund të grupohen në mbi 20 fusha kuptimore.

Jemi të mendimit se vendin e parë e zë fusha e kuzhinës dhe e gjellëtarisë d.m.th. emërtime gatesash, ëmbëlsirash, pijesh, lëndësh ushqimore e përdorësesh të kuzhinës.

Të tilla janë: *burani, jahni, meze, pace, pilaf, qofte, rishte, samsa, trahana, turshi; paluze, pelte, recel, revani, sheqerpare, zerde; bozë, narden, pekmez, vishnjë; maja, niseshte, sheqer; cini, farfuri, hanxhar, havan, kuze, qepshe, rende (që ka dhënë rendoj, rendim), tas, tavë; majhosh, taze.*

Shumica e këtyre fjalëve i përkasin leksikut aktiv, d.m.th. janë fjalë që përdoren gjerësisht, janë emërtime të vetme për sendet që shënojnë. Turqizmat janë të pranishme më së shumti në fushën e kuzhinës e të gatesave. Pa dyshim kjo lidhet me shkallën e lartë që kishte arritur prej kohësh arti i kuzhinës osmane, natyrshëm edhe nga kontakti i ngushtë me vendet e lindjes në tërësi.

Emërtimet që lidhen me banesën dhe me pajisjet e saj: *si qilar, sofër, baxhë, cercive, gjerdek, hambar, kafaz, qoshe, bohce, çarçaf, legen, perde, penxhere, bodrum, peshqir, poste, postiqe, qilim etj.*

Ndryshe nga fjalët e sferës së kuzhinës, këtu një pjesë e madhe kanë përdorim të kufizuar ose po dalin nga përdorimi me modernizimin e jetës. Megjithatë jemi të mendimit sikurse na paraqisin edhe anketat e bëra që shumë fjalë të tilla po i rezistojnë mrekullisht zhvillimeve ekonomike të kohës.

Të këtilla janë fjalët: *perde, kovë, legen, peshqir, etj* të cilat përdoren të vetme pavarësisht se llojet dhe emërtimet e tyre janë shtuar e shtohen dita ditës.

Emërtimet nga fusha e bimësisë; *filizë, bajame, fëstëk, karpuz, gonxhe, hurmë, jasemin, manushaqe, pambuk, panxhar, patëllxhan, shebojë, sheftali, zerdeli, zymbyl, misër, vishnjë, kajsi etj.*

Nga fusha e almiseve: *bel, çark, çengel, çirak, kandil, pishtar, nargjile, qese, shishe, zembrek, zumpara etj.*

Turqizma që kanë të bëjnë me njeriun dhe me tiparet e tij fizike e morale; *naze, nishan, pishman, teveqel, qorr, serbest, viran, xhan, xhanan, zor, kolaj, dembel, hajdut, piseveng etj.*

Veshmbathja dhe fjalët që lidhen me to: *çorap, papuçe, perçe, qylah, sytjena, shallvare, tumane* etj.

Fjalë nga emërtimet e mjeshtërive: *çirak, çoban, pehlivan, terzi, usta, xhambaz.*

Nga fusha e tregtisë dhe jetës qytetare; *bedava / badihava, dyqan, paha, para, pazar, veresije, qar, sheqer, karvan, çarshi, çekmë, han, mejhane, pazar, saraj, shatërvan* etj.

Kozmetika, stilitë dhe zbukurimet; *byrzylyk, gjerdan, maniqr, bojë* etj

Feja dhe besimi; *xhami, pejgamber, avdes, dervish, gjynah, gjyhnaqar, hoxhë, namaz, nevrüz, imam, myfti, sevap, dua* etj.

Interesant është fakti që shqipja ka qenë e fortë të ruaj fjalët e veta në lidhje me praktikën fetare. Kjo është e dukshme sidomos tek praktikantët e fesë muslimane të ciltë në ritet e tyre fetare përdorin fjalë që shqipja i ka pasur para kontaktit me osmanët, vlen të përmendim fjalën *agjërim* e cila ruan përdorim mbarëshqiptar si te të krishterët ashtu edhe te muslimanët.

Ushtria dhe lufta; *biçak, çadër, dylbi, top, hanxhar* etj. Vegla muzikore; *qemane, saze, zurna, aheng* etj.

Bujqësia; *bahçe, bahçevan, zarzavate*; Ndërtimi; *qemer, qereste, direk* etj
Kafshë dhe shpendë; *bilbil, çakall, kumri, lejlek* etj. Fusha detare; *direk, gjemi, hambar, kiç, bash, demir, etj.*

Familja dhe farefisnia; *hallë, teze, xhaxha, dajë, byrazer, ane, mixhë, baxhanak.* Fjalë të trupit të njeriut: *bel-i, qerpik-u, mide-ja.*

Fjalët që u përmendën deri këtu, janë përfshirë në FGJSSH, por ka edhe një varg fjalësh të tjera që janë mjaft të njohura, sidomos nga brezi i mesëm e i vjetër, p.sh. *birjan, cinar, derbeder, dizdar, dylber, ezber, namazgjah, nargjize, paraqende, percin, percinos, tehma, tesqere, turfanda, xhumush*, të shtojmë këtu edhe disa fjalë që i dinë të gjithë ata që luajnë tavëll: *dumbare, dyshesh, jek, shesh.*

Nga pikëpamja gramatikore turqizmat e shprahbundit ballkanik në shumicën dërrmuese janë emrakonkretë një pakicë emra abstraktë, si *baft, çare, derman, medet, nam, rast, sevda, bosh* etj.

Mbiemrat; çapraz, qorr, taze, viran, dembel, llafazan. Ndajfoljet; peshin, veresije, pishman, serbes etj.

Foljet; sejdís, sikteris, çel, bojatis, begenis etj.

Fonlogjia

Qëmtimi i dukurive në rrafshin *fonologjik* lidhet drejtpërsëdrejti me ndikimet, apo me huazimet, që gjuha shqipja njohu gjatë kontaktit gjuhësor me turqishten e periudhës së perandorisë osmane, çka ndihmon jo pak në drejtim të formimit të një perceptimi më objektiv rreth shkallës dhe dendësisë jo thjesht dhe vetëm të kontaktit gjuhësor, por edhe të marrëdhënieve ndërnjerëzore ndërmjet folësve të këtyre dy bashkësive gjuhësore.

Vështruar në rrafshin fonologjik, mes gjuhës shqipe dhe turqishtes së periudhës së perandorisë osmane mund të qoken katër tipare të përgjithshme, të cilat mund të hamendësohet se janë rrjedhojë e dukurisë së kontaktit gjuhësor.

Më konkretisht:

Rënia e zanores tingull-lartë kur ajo është fundore dhe paraprihet nga një tingull i çerdhes fonematike të i-së (që mund të jetë pjesë e M-së, y-së apo u-së së theksuar. Pavarësisht se në shqipekziston tingulli përkatës, sërishmi, ky tipar i turqishtes ka gjetur vend; shembull për këtë janë fjalët me zanoren e butë të theksuar në fund të emrave të pashquar; i vetmi përjashtim janë disa fjalë një rrokëshe të toskërishtes, të cilat në gegërisht i përgjigjen zanoreve hundore, si për shembull: sy/sy, dru/dru, zë/'za^{etj}.

Humbja apo rënia e zanores mbyllore kur gjendet në pozicion nistor; Qiellëzimi i zanoreve prapaqiellëzore

Rënia e bashkëtingëllores së pazëshme h.

Përfundime

Vatra gjuhësore ballkanike përbëhet nga gjuhë, të cilat janë pjesë e familjes indoevropiane dhe paraqesin një degëzim të saj të veçantë. Mes këtyre gjuhëve ekziston një gjerdan ngjashmërisht në rrafshin

fonologjik dhe morfosintaksor, të cilat janë rrjedhojë e kontakteve më tepër të natyrës antropologjike, sesa të natyrës politike, sociale, fetare apo kulturore.

Krahas ngjashmërive nga kontaktet e natyrës antropologjike, thuajse gjithnjë të drejtpërdrejta, gjuhët e *Sprachbund-it* ballkanik shfaqin edhe një gjerdan ngjashmërisht të “mbjella”, nëse mund të shprehem kështu. Fjala është shprehimisht për një gjerdan të gjatë dhe të pasur orientalizmasht, të cilat arritën të depërtonin në gjuhët e *Sprachbund-it* ballkanik përmes kontaktit të gjatë dhe intensiv që folësit përkatës patën me osmanët. Në këtë rast, osmanishtja, por edhe dialekte të tjera të turqishtes, *volens od nolens* u shndërrua në një “superstratum”, më së tepërmi falë aspekteve historike, politike, ekonomike dhe administrative, sesa atyre kulturore. Si rrjedhojë e zhvillimeve të mëvonshme historike, kush më shumë e kush më pak, që të tërë popujt e *Sprachbund-it* ballkanik u përpoqën që t’i pastronin të tillë elementë, e megjithatë, një nismë e tillë “puriste” nuk arriti të japë përpos se disa rezultate të pjesshme, duke nxjerrë edhe një herë në pah se si zhvillimet e gjuhës nuk shkojnë gjithnjë me të njëjtin hap me zhvillimet politike dhe ideologjike.

BIBLIOGRAFIA

- JOHANSON L., 1998, *The Turkic Languages*, Routledge, London, 192 et passim.
- FRIEDMAN V.A., (1982) , *Balkanology and Turcology: West Rumelian Turkish in Yugoslavia as Reflected in Prescriptive Grammar*, në: *Studies in Slavic and General Linguistics*, Radopi, Amsterdam, vëll. II, f. 1-77.
- MARTIN, L. (1986). Eskimo Words for Snow: A Case Study in the Genesis and Decay of an Anthropological Example. *American Anthropologist*, LXXXVIII.
- POLISI, M. (2006). Leksiku Islam, Pjesë përbërëse e leksikut të shqipes. *Terminologjia Islame*, ASHAK, Prishtinë.
- RIFAT, M. (2005). XX. Yüzyılda Dilbilim ve Göstergebilim Kuramları-2 /Temel Metinler, İstanbul, YKY, 2th Edition, Ankara
- SAUSSURE, F. (1998). *Genel Dilbilim Dersleri*, Multilingual Yayınları, İstanbul.
- SHKURTAJ, G. (2003). *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë.
- SLOBIN, D. (1996). *From Thought and Language to Thinking for Speaking* in: J. Gumperz, S. Levinson (a curadi), *Rethinking Linguistic Relativity*, USA: Cambridge.